

PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT TË SË FOLURIT DHE GJUHËS NDAJ FËMIUT SHUMËGJUHËSORË

Reth rëndësisë së gjuhës amtare

Gjuha amtare është gjuha më e rëndësishme e fëmiut. Është gjuha e sensit dhe e të së menduarit. Është gjuhë e përbashkët e fëmiut dhe prindërve. Poashtu është rrugë për në kulturën e fëmiut dhe historinë e tij.

Zakonisht fëmijët e familjeve shumëgjuhësore mësojnë së pari gjuhën amtare e pastaj gjuhën finlandeze. Prindërit duhet që gjithmonë të flasin me fëmiun në gjuhën e vet amtare.

Kur strukturat e gjuhës amtare janë të mbizotëruara mirë, është lehtë të mësohen strukturat e gjuhëve tjera pra gramatika e tyre.

Kur fjalorthi i fjalëve dhe koncepteve në gjuhën amtare është i gjërë, është lehtë të mësohet fjalorthi i gjuhës tjetër dhe konceptet e saj.

Kur di të përdorë gjuhën e vet amtare në të treguar, spjegim dhe bisedë, është lehtë të mësohen gjërat e njejta në gjuhë tjetër.

Është me rëndësi që zhvillimi i gjuhës amtare në shtëpi të përkrahët fuqimisht. Përndryshe është e mundur që gjuha amtare të mbetet më e dobët se gjuha finlandeze. Aftësia e dobët në gjuhën amtare vështirëson mësimin e gjuhës së re.

PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT TË SË FOLURIT

Fëmiu nën 1 vjeçar

Fëmiut i pëlqen të jetë afër dhe në krahërorë. Bisedo shumë me fëmiun duke e shiqur në sy. Kur të kujdesohesh për fëmiun psh. i bën banjo apo e veshë, tregoi në të njejtën kohë se çka je duke bërë. Kur fëmiu është i interesuar për njerzit dhe gjësendet në mjedisin që e rrethon, tregoi fëmiut se çka janë ata/ato. Në këtë mënyrë fëmiu mëson së pari të kuptoj fjalë të reja e pak më vonë edhe të i thotë vetë këto fjalë.

Lojra:

Të fshehurit

Lojrat ku xigëlohet dhe duartrokitet

Ninullat dhe këngët

Lojrat merre-ama

Lodrat:

Gjësende shtëpiake psh. kapaku i tenxheres, kutllaq druri, enë plastike, reflektues, top, katrorë druri, kuti.

1 – 2 vjeçari

Fjalorthi i fëmiut rritet. Kur i vëren fjalët e fëmiut dhe tentimet për të folur, përgjigjju atyre. Psh. fëmiu thotë: "Lii-bi" e nëna i përgjigjet: "Poo-o së shpejti e lexojmë librin. Nëna së pari po i varë rrobet për t'u terur".

Kur i bën punët e shtëpisë apo jeni jashtë me fëmiun, tregoj në të njejtën kohë se çka je duke bërë apo çka është fëmiu vetë duke bërë. Pyete fëmiun për gjëra të njohura / zakonshme si p.sh. "Ku është vetura (kerri)? apo "A don banane apo mollë?"

Shiko së bashku me fëmiun libra me fotografi dhe tregoj për fotografitë në të. Shpesh fëmiu vetë tregon me gisht ndonjë fotografi që i intereson. Fëmiu i mëson më së miri fjalët rreth gjërave që i interesojnë atij.

Lodra dhe lojra: Lojrat e lehta me copë, Duplo-lego, sende për lojrat "me shtëpia" apo "me veturë (kerr)", libra me fotografi, sende për lojra jashtë. Ninullat dhe këngët së bashku me fëmiun.





3 – 4 vjeqari


Shumë fëmijë të kësaj moshe pyesin shumë. Përgjigjju pyetjeve së fëmiut dhe bisedo me atë. Është me rëndësi që i rrituri të i tregojë dhe spjegojë fëmiut ngjarjet e ditës dhe gjërat e përjetuara së bashku.

Fëmiu mëson të luaj së bashku me fëmijët tjerë dhe mëson shumë prej fëmijëve me të rritur.

Në këtë fazë është mirë që të fillohet me njoftimin me gjuhën finlandeze psh. në klube të fëmijëve, parqe për lojë apo në qerdhe të hapur.

Loja e fëmiut tani është bukur e shumëanshme. Në këtë moshë fëmiu flet shumë, gjatë kohës kur lozë. Ai spjegon me zë lojën e vet duke e drejtuar rrjedhën e saj. Loja është e rëndësishme për zhvillimin e të së folurit të fëmiut.

Fëmiut i pëlqen të lëvizurit. Ai ngjitet, vrapon, kërcen dhe mëson të ngasë bicikletën. Përpos lodrave është e udhës që fëmiu të përdorë lapsin, letrën dhe gërsërët për fëmijë.



5 - 6 vjeqari

Fëmiu ka durim që të ndëgjoj tregime, legjenda të lashta dhe përralla. Prej këtyre ai mëson përdorim më të shumëanshëm të gjuhës dhe fjalorth se sa prej gjuhës së përditshme.

Si pesë vjeqar është e udhës që fëmiu rregullisht të jetë në mjedis ku flitet gjuha finlandeze psh. në qerdhe.

Si gjashtë vjeqar fëmiu do të ishte mirë që të shkoj në shkollë në mësim parashkollor parapregaditës. Fëmiut si parashkollor apo i moshës shkollore mund t'i jipet mësim në gjuhën amtare dhe rreth kulturës amtare.



Terapia e së folurit

Terapeutët e së folurit përkujdesohen rreth pengesave së fëmijëve dhe të rriturve në të folur, gjuhë dhe komunikim. Punës së tyre i takon egzaminimi i pengesave në të folur, rehabilitimi dhe parandalimi. Terapia e së folurit është rehabilitim mjekësor. Terapeutët e së folurit janë persona profesional të autorizuar të kujdesit shëndetsor.

Në të shumtën e rasteve këshillëmorja e fëmijëve udhëzon fëmiun për në pranimin e terapeutit të së folurit. Poashtu edhe qerdhet mund të rekomandojnë egzaminim nga ana e terapeutit të së folurit. Egzaminimet mund të fillohen edhe në bazë të dëshirës së shprehur nga ana e prindërve.

Terapeuti i të së folurit mund të egzaminoj aftësinë në gjuhën finlandeze së fëmiut që flet këtë gjuhë si gjuhë të huaj. Terapeuti poashtu mund të egzaminoj edhe përparimin e aftësisë në gjuhën finlandeze. Arsye për të bërë egzaminim ka nëse fëmiu ka probleme në gjuhën e vet amtare apo nëse ai mëson gjuhën finlandeze veqanërisht ngadal. Aftësia në gjuhën amtare mund të analizohet me ndihmën e prindërve apo të përdoret ndihma e përkthyesit gjatë egzaminimit. Terapia e së folurit nuk është mësim i gjuhës finlandeze.

Terapia e së folurit nevojitet kur

fëmiu flet shumë më pak se moshatarët e tij

- 2 vjeçar e 1/2 e ende nuk flet fjalë
- 3 vjeçar e nuk flet ende fjali

në të kuptuar të së folurit ka probleme

- 2 vjeçari nuk kupton fjalë të njohura / zakonshme
- fëmiu nuk di të veprojë sipas udhëzimeve të lehta
- në krahasim me fëmijët e moshës së tij nuk ka durim të përcjellë biseda apo ndëgjojë dikend kur lexon ndonjë libër

të folurit e fëmiut është e paqartë

- të folurit e 3 vjeçarit nuk kuptohet
- 5 vjeçari ka gabime në të shqiptuar (psh. fëmiu nuk di t'a thotë r : në)

fëmiu belbëzon

- belbëzimi ka zgjatur disa muaj

Këshillëmorja e fëmijëve dhe qerdhet iu japin informata rreth terapeutit të së folurit me të afërt dhe udhëzime se si të rezervohet termini për egzaminim.

Vantaan kaupungin puheterapeuttien työryhmä:
Grupi punues i terapeutëve të së folurit të
qytetit të Vantaa-së:

Maarit Elovaara
Johanna Kivi
Leena Lindholm
Annina Manninen
Arja Nieminen

Käännös:
Përkthimi:

Pääkaupunkiseudun
Asioimistulkkikeskus